



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.56

18 prill

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 10.4.2008	Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për vitin 2007	2483
Rezolutë e Kuvendit datë 14.4.2008	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2007	2484
Vendim i Kuvendit nr.178, datë 14.4.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.97, datë 30.4.2007 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT)”	2485
Vendim i Kuvendit nr.179, datë 14.4.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.116, datë 23.7.2007 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Avokatit të Prokurimeve”	2490
Vendim i KM nr.392, datë 8.4.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar	2492
Vendim i KM nr.395, datë 8.4.2008	Për lejimin e kalimit transit të një konvoji ushtarak sloven, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	2493
Vendim i KM nr.399, datë 27.3.2008	Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve të përhershëm të Akademisë së Shkencave ...	2494
Vendim i KM nr.401, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Baldushk, të qarkut të Tiranës	2494

Vendim i KM nr.402, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Qukës, të qarkut të Elbasanit	2508
Vendim i KM nr.403, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bradashesh, të qarkut të Elbasanit	2515

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE PËR VITIN 2007

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur dhe mbështetur punën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si një institucion i pavarur që merret me administrimin dhe kontrollin e deklarimit të pasurisë, të detyrimeve financiare dhe parandalimin e konfliktit të interesave, për subjektet e parashikuara në ligj;

- duke vlerësuar dhe përkrahur punën e këtij institucioni në luftën kundër korrupsionit;

- duke nxitur bashkëpunimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit,

Konstaton se:

- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive ka dhënë rezultatet e para në luftën kundër korrupsionit dhe për parandalimin e konfliktit të interesave;

- ka marrë nismën dhe ka dëshmuar një vullnet të mirë për bashkëpunimin ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik;

- ka zhvilluar trajnime me subjektet e parashikuara në ligj, në lidhje me zgjidhjen e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive;

- ka ushtruar kompetencat e tij për dhënien e masave administrative, në zbatim të ligjit, për personat që nuk e kanë dorëzuar në kohë deklarimin e pasurisë.

Kuvendi kërkon për vitin 2008:

- angazhimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për zbatimin e plotë të legjislacionit për kontrollin e pasurisë, të detyrimeve financiare, si edhe për parandalimin e konfliktit të interesave, në lidhje me sanksionet e parashikuara në këto ligje;

- forcimin e aftësive investiguese të institucionit;

- rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera e në mënyrë të veçantë me prokurorinë, për sa i përket ndjekjes së denoncimeve të bëra, me qëllim kryesor parandalimin e korrupsionit dhe krimit ekonomik;

- futjen në raportin vjetor të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për Kuvendin të vlerësimit për bashkëpunimin e vet me institucionet e tjera, që kanë detyrë ligjore të luftojnë krimin ekonomik;

- intensifikimin e punës njohëse dhe edukuese të subjekteve të deklarimit edhe nëpërmjet mediave, reklamave ose emisioneve të posaçme.

10 prill 2008

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2007

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur rëndësinë kushtetuese të institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

- duke vlerësuar rolin e këtij institucioni të paanshëm për rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës shtetërore në nivel qendror e vendor, sistemit gjyqësor dhe prokurorisë, nëpërmjet rekomandimeve të dhëna dhe masave të propozuara;

- duke mbështetur fuqimisht veprimtarinë e këtij institucioni për krijimin e standardeve bashkëkohore në fushën e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut dhe kontributit të dhënë për përmirësimin e legjislacionit vendas, sipas standardeve ndërkombëtare,

Vëren se për vitin 2007:

- veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2007 ka synuar mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë, në përputhje me Kushtetutën, konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar;

- institucioni i Avokatit të Popullit ka punuar për përmbushjen e objektivave, sipas rezolutës së miratuar nga Kuvendi;

- ka zhvilluar një volum pune të konsiderueshëm, duke i dhënë drejtimin e duhur edhe ankesave që janë jashtë juridiksionit të tij;

- marrëdhëniet me Kuvendin, Këshillin e Ministrave, institucionet e tjera qendrore dhe ato të pavarura kanë ardhur duke u përmirësuar në mënyrë të ndjeshme;

- marrëdhëniet me shtetasit shqiptarë, duke shkuar si institucion pranë tyre në bashki, komuna apo qarqe, kanë dhënë rezultate të dukshme në punën e tij.

Kuvendi kërkon për vitin 2008:

- angazhimin më të plotë të institucionit të Avokatit të Popullit për kryerjen e një pune informuese dhe sqaruese për kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, si dhe për mbrojtjen e respektimin e të drejtave të njeriut;

- vendosjen e një marrëdhënieje bashkëpunimi të vijueshëm me Televizionin Publik Shqiptar, për të vendosur një komunikim të drejtpërdrejtë me të gjithë shtetasit shqiptarë;

- rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të publikut për kërkimin e të drejtave të shkelura apo të mohuara;

- vendosjen e mbajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit e të mirëkuptimit si me organizmat ndërkombëtarë, ashtu edhe me forcat politike, shoqërinë civile, organizatat jofitimprurëse dhe median;

- ndjekjen deri në përmbushje të rekomandimeve të bëra dhe masave të propozuara të këtij institucioni drejtuar institucioneve shtetërore dhe administratës publike;

- denoncimin në vijimësi të shkeljeve të të drejtave të shtetasve nga administrata shtetërore, qendrore apo vendore.

14 prill 2008

VENDIM
Nr.178, datë 14.4.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 97, DATË 30.4.2007 TË KUVENDIT “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË ENTIT RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE (ERT)”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr.97, datë 30.4.2007 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT)”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

I. Lidhja nr.2 “Organika e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve” zëvendësohet me lidhjen nr.2 bashkëlidhur.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

ORGANIKA E ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I. KËSHILLI DREJTUES		(6)
KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES (DREJTOR EKZEKUTIV)		1
ANËTARË TË KËSHILLIT DREJTUES		4
SEKRETAR I KËSHILLIT DREJTUES		1
II. KABINETI		(3)
DREJTOR KABINETI		1
KËSHILLTAR (LIGJOR)		1
SEKRETAR I DREJTORIT EKZEKUTIV		1
III. DREJTORIA JURIDIKE		(5)
DREJTOR DREJTORIE		1
SEKTORI I AKTEVE LIGJORE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1
ZYRA E MOSMARRËVESHJEVE		(1)
SPECIALIST	III-b	1
IV. DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK		(8)
DREJTOR DREJTORIE		1
SEKTORI I TARIFAVE DHE ANALIZËS SË KOSTOS		(2)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
SEKTORI I AKSESIT DHE INTERKONEKSIONIT		(2)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
SEKTORI I STUDIMIT DHE ANALIZËS SË TREGUT		(2)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
ZYRA E SHËRBIMIT UNIVERSAL		
DHE MBROJTJES SË PËRDORUESVE		(1)
SPECIALIST	III-b	1
V. DREJTORIA E RREGULLIMIT TEKNIK		(12)
DREJTOR DREJTORIE		1
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË SPEKTRIT TË		
RADIOFREKUENCAVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT		
TË SPEKTRIT TË RADIOFREKUENCAVE		(2)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
SEKTORI I NUMERACIONIT, MIRATIMIT TË TIPIT		
DHE TREGUESVE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË DOMAIN-IT.AL		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
VI. DREJTORIA E LICENCIMIT		(6)
DREJTOR DREJTORIE		1
SEKTORI I OPERATORËVE DHE OFRUESVE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I OPERATORËVE TË PAVARUR		(2)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
VII. DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE MONITORIMIT TË SPEKTRIT		(7)
DREJTOR DREJTORIE		1
SEKTORI I MONITORIMIT TË SPEKTRIT TË RADIOFREKUENCAVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I INSPEKTIMIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
VIII. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME		(12)
DREJTOR DREJTORIE		1

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
SEKTORI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(8)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST ARKIV PROTOKOLLI	IV-b	1
SHOFER		3
TEKNIK MIRËMBAJTJEJE		1
MAGAZINIER / NËPUNËS INFORMACIONI		1
PUNONJËS PASTRIMI		1
IX. ZYRA E MARRËDHËNIEVE PUBLIKE DHE ME JASHTË		(1)
SPECIALIST	III-b	1
PUNONJËS GJITHSEJ		60

VENDIM
Nr.179, datë 14.4.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.116, DATË 23.7.2007 TË KUVENDIT “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË AVOKATIT TË PROKURIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", me propozimin e Avokatit të Prokurimeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr.116, datë 23.7.2007 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Avokatit të Prokurimeve”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

I. Lidhja nr.2 “Organika e zyrës së Avokatit të Prokurimeve” zëvendësohet me lidhjen nr.2 bashkëlidhur.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

LIDHJA 2**ORGANIKA E ZYRËS SË AVOKATIT TË PROKURIMEVE**

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I. AVOKATI I PROKURIMEVE		1
SEKRETAR/ARKIVIST		1
II. DREJTORIA E ANKESAVE DHE MONITORIMIT		(4)
DREJTOR DREJTORIE		1
SPECIALIST	III-b	3
III. DREJTORIA E HETIMIT		(4)
DREJTOR DREJTORIE		1
INSPEKTOR		3
IV. DREJTORIA E BUXHETIT, FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(5)
DREJTOR DREJTORIE		1
SEKTORI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE DHE ASISTENCËS LIGJORE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	IV-a	1
SHOFER		1
SEKTORI I BUXHET-FINANCËS		(1)
SPECIALIST	IV-a	1
PUNONJËS GJITHSEJ		15

VENDIM
Nr.392, datë 8.4.2008

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN
PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin “Rregullat për prokurimin publik”, që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I “Organizimi i prokurimit publik”, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “d” të pikës 2 “Prokurimi i përqendruar dhe organi qendror blerës”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nëse autoriteti kontraktor, në përcaktimin e të dhënave sasiore, ka marrë për bazë çmime të ndryshme, që nuk u afrohen atyre të tregut, organi qendror blerës mund të krijojë një grup pune të përbashkët, me përfaqësues të autoritetit, i cili bën testimin e tregut dhe përllorarit të dhënat sasiore, sipas fondit të vënë në dispozicion.”.

b) Në pikën 3 “Botimi i njoftimeve të kontratës”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i) Fjalja e tretë e shkronjës “c” shfuqizohet dhe zëvendësohet me “Afati i fundit i pranimit të njoftimit është deri në 5 ditë përpara publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, pasardhës. Ky afat nuk do të zbatohet në rastet kur hedhja e njoftimit në sistem bëhet nga vetë autoritetet kontraktore, sipas udhëzimeve të APP-së.”.

ii) Fjalja e fundit e paragrafit të parë të shkronjës “ç” shfuqizohet dhe zëvendësohet me “Afati i fundit i pranimit të njoftimit për publikim është deri në 5 ditë përpara publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, pasardhës. Ky afat nuk do të zbatohet në rastet kur hedhja e njoftimit në sistem bëhet nga vetë autoritetet kontraktore, sipas udhëzimeve të APP-së.”.

2. Në pikën 2 të kreut III, “Dokumentet e tenderit” bëhen shtesat e mëposhtme:

c) Në shkronjën “e”, pas fjalisë së parë të paragrafit të dytë, shtohet fjalja, me këtë përmbajtje:

“Në rastet e procedurave të prokurimit për blerjen e energjisë elektrike, ofertuesit duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2 për qind të ofertës së paraqitur në këto procedura prokurimi.”.

b) Në shkronjën “ë”, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në procedurat e prokurimit për blerjen e energjisë elektrike, në rast se kontraktori nuk lëvtron plotësisht/pjesërisht sasinë e kontraktuar, autoriteti kontraktor konfiskon, nga vlera e sigurimit të kontratës, vlerën për sasinë e energjisë elektrike të palëvruar, e cila llogaritet si diferencë e çmimit më të lartë, për të cilin autoriteti kontraktor ka ose do të ketë mundësi ta blejë energjinë elektrike të palëvruar. Vlerës së mësipërme duhet t’i nënshtrohen edhe kostot e mundshme për sigurimin e rrugëve të transmetimit, si dhe kostot e tjera përkatëse, të dokumentuara. Në këtë rast, kur vlera e sigurimit të kontratës është më e vogël se vlera që autoriteti kontraktor duhet të konfiskojë, diferenca mbahet nga vlera e pagesës, që autoriteti kontraktor do t’i paguajë kontraktuesit për sasinë e energjisë elektrike të lëvruar.”.

3. Në pikën 3 “Kohëzgjatja e kontratës” të kreut VII “Kushte të përgjithshme për zbatim”, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën “a”, pas fjalëve “... me shkronjën “b”...” shtohen fjalët “... të pikave 3 e 5...”.

b) Në shkronjën “b” shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Objekti i tyre është mirëmbajtja e mjeteve kompjuterike apo mirëmbajtja e sistemeve elektronike/kompjuterike, me shtrirje gjeografike dhe/ose institucionale, që bën të nevojshëm

zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, ngritjen e ekspertizës dhe/ose të infrastrukturës. Këtu, gjithashtu, përfshihen edhe kontratat e shërbimit të ndërlidhjes (konjektivitetit) në shumë pika, në rastet kur kanë tarifë fillestare instalimi. Kohëzgjatja e këtyre kontratave nuk duhet të kalojë 4 vjet.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.395, datë 8.4.2008

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË KONVOJI USHTARAK SLOVEN,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të një konvoji ushtarak sloven, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 4 (katër) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 14 prill 2008. Një prej automjeteve është shoqëruar dhe nisur nga Prishtina po në këtë datë.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për automjetin shoqëruar të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për konvojën ushtarak sloven të jetë Porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Konvoi ushtarak sloven, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.399, datë 27.3.2008

**PËR MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË RREGULLT DHE
TË ANËTARËVE TË PËRHERSHËM TË AKADEMISË SË SHKENCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 e 16 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e rregullt dhe anëtarët e përherëshëm të Akademisë së Shkencave përfitojnë një shpërblim mujor, për titullin “Akademik”, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj.
2. Kjo pagesë të bëhet nga Akademia e Shkencave dhe të përballohet nga buxheti vjetor, miratuar për këtë institucion.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.401, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA BALDUSHK, TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Baldushk, të qarkut të Tiranës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.
2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë, që përfundon me numrin rendor 377 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Baldushk për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARE PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Sipas inventarizimit te pronave te veçanta te tipit,Pyje,Kullota,Livadhe,Shkembore etj)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU										
Komuna: Baldushk										
Nr. rend.	Nr. sipas invent.	Emertesa e Ekonomisë pyjore dhe kullimore(EPK) shtrirja Gjeografike e EPK	Emertesa e ngastres Vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastres	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Të dhena te tjera Shenime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	51	Ek.pyjore Baldushk	Perroi i Veskise	14a	Py.prodh	12.1	"	"	"	"
2	52	"	Perroi i Veskise	14a/1	Py.prodh	1.45	"	"	"	"
3	53	"	Perroi i Veskise	14c	Py.prodh	13	"	"	"	"
4	54	"	Perroi i Veskise	14c/1	Toke e re	1.5	"	"	"	"
5	55	"	Perroi i Veskise	14d	Py.prodh	1.72	"	"	"	"
6	56	"	Perroi i Veskise	14d/1	Py.prodh	0.26	"	"	"	"
7	57	"		14e	Sip.zhvesh	5.75	"	"	"	"
8	58	"	Perroi i Veskise	15a	Py.prodh	5.5	"	"	"	"
9	59	"	Perroi i Veskise	15c	Py.prodh	12	"	"	"	"
10	60	"	Perroi i Veskise	15c/1	Toke e re	1.1	"	"	"	"
11	61	"	Perroi i Veskise	15c/1	Py.prodh	0.66	"	"	"	"
12	62	"	Perroi i Veskise	15d	Py.prodh	2	"	"	"	"
13	63	"		15e	Sip.zhvesh	11.5	"	"	"	"
14	64	"	Kodra e Lamit	16a	Py.prodh	8.5	"	"	"	"
15	65	"	Kodra e Lamit	16c	Py.prodh	7.3	"	"	"	"
16	66	"	Kodra e Lamit	16c/1	Py.prodh	5.47	"	"	"	"
17	67	"	Perroi i Goces	17a	Py.prodh	3	"	"	"	"
18	68	"	Perroi i Goces	17a	Py.prodh	1.2	"	"	"	"

19	69	"	Perroi i Goces	17c	Py.prodh	18.37	"	"	"	"
20	70	"	Perroi i Goces	17c/1	Py.prodh	1.7	"	"	"	"
21	71	"	Perroi i Goces	17d	Py.prodh	2.8	"	"	"	"
22	72	"	Perroi i Goces	17d/1	Sip.zhvesh	2.1	"	"	"	"
23	73	"	Perroi i Goces	17e	Py.prodh	2.8	"	"	"	"
24	74	"	Perroi i Goces	17e/1	Py.prodh	2.1	"	"	"	"
25	75	"		17f	Sip.zhvesh	20	"	"	"	"
26	76	"	Perroi i Veshit	18a	Py.prodh	5.25	"	"	"	"
27	77	"	Perroi i Veshit	18c	Py.prodh	7.7	"	"	"	"
28	78	"	Perroi i Veshit	18c/1	Py.prodh	1.65	"	"	"	"
29	79	"	Perroi i Veshit	18d	Py.prodh	3	"	"	"	"
30	80	"		18e	Sip.zhvesh	14.25	"	"	"	"
31	81	"	Perroi i Veshit	19a	Py.prodh	8.65	"	"	"	"
32	82	"	Perroi i Veshit	19a/1	Py.prodh	0.3	"	"	"	"
33	83	"	Perroi i Veshit	19b	Sip.zhvesh	29	"	"	"	"
34	84	"	Perroi i Caracit	20a	Py.prodh	11.1	"	"	"	"
35	85	"	Perroi i Caracit	20c	Py.prodh	13	"	"	"	"
36	86	"		20d	Sip.zhvesh	19.75	"	"	"	"
37	87	"	Perroi i Caracit	21a	Py.prodh	14.6	"	"	"	"
38	88	"	Perroi iCaracit	21a	Py.prodh	0.2	"	"	"	"
39	89	"		21c	Sip.zhvesh	9.5	"	"	"	"
40	90	"		21d	Sip.inprod	3.25	"	"	"	"
41	91	"	Veskia	22a	Py.prodh	6.07	"	"	"	"
42	92	"	Veskia	22a/1	Py.prodh	0.34	"	"	"	"
43	93	"	Veskia	22c	Py.prodh	4.8	"	"	"	"
44	94	"	Veskia	22c/1	Py.prodh	1.6	"	"	"	"
45	95	"		22d	Sip.zhvesh	15.25	"	"	"	"
46	96	"	Perroi i Shetzit	23a	Py.prodh	4.8	"	"	"	"
47	97	"	Perroi i Shetzit	23a/1	Py.prodh	1.6	"	"	"	"
48	98	"	Perroi i Shetzit	23c	Py.prodh	9.75	"	"	"	"
49	99	"	Perroi i Shetzit	23d	Py.prodh	7.2	"	"	"	"

50	100	"		23e	Sip.zhvesh	2	"	"	"	"
51	101	"	Perroi i Shetzit	24a	Py.prodh	6.75	"	"	"	"
52	102	"	Perroi i Shetzit	24c	Py.prodh	8	"	"	"	"
53	103	"	Perroi i Shetzit	24d	Py.prodh	16.5	"	"	"	"
54	104	"	Burimet e Sharres	25a	Py.prodh	7	"	"	"	"
55	105	"	Burimet e Sharres	25b	Py.prodh	13.5	"	"	"	"
56	106	"		25c	Sip.zhvesh	8.75	"	"	"	"
57	107	"	Mali Sallavak	26a	Py.prodh	12.61	"	"	"	"
58	108	"		26b	Kullote	6.25	"	"	"	"
59	109	"	Mali Sallavak	26c	Py.prodh	13.25	"	"	"	"
60	110	"		26d	Sip.zhvesh	18.25	"	"	"	"
61	111	"	Mali Sallavak	27a	Py.prodh	25.75	"	"	"	"
62	112	"		27b	Sip.zhvesh	10	"	"	"	"
63	113	"	Pylli i Dhive	28a	Py.prodh	11.4	"	"	"	"
64	114	"	Pylli i Dhive	28a/1	Py.prodh	3.8	"	"	"	"
65	115	"	Pylli i Dhive	28b	Py.prodh	5.56	"	"	"	"
66	116	"	Pylli i Dhive	28b/1	Py.prodh	1.47	"	"	"	"
67	117	"		28c	Livadh	2.25	"	"	"	"
68	118	"		28d	Sip.zhvesh	2.5	"	"	"	"
69	119	"	Perroi i Shetzit	29a	Py.prodh	4.35	"	"	"	"
70	120	"	Perroi i Shetzit	29a/1	Py.prodh	9.2	"	"	"	"
71	121	"	Perroi i Shetzit	29b	Py.prodh	2	"	"	"	"
72	122	"		29c	Sip.zhvesh	11.75	"	"	"	"
73	123	"	Perroi i Gorres	30a	Py.prodh	4.75	"	"	"	"
74	124	"	Perroi i Gorres	30a	Py.prodh	0.75	"	"	"	"
75	125	"	Perroi i Gorres	30b	Py.prodh	14.5	"	"	"	"
76	126	"	Perroi i Gorres	30c	Py.prodh	16	"	"	"	"
77	127	"	Perroi i Gorres	30d	Py.prodh	14.25	"	"	"	"
78	128	"		30e	Sip.zhvesh	10.75	"	"	"	"
79	129	"	Pylli i Djegur	31a	Py.djegur	43	"	"	"	"
80	130	"	Pylli i Djegur	31a/1	Py.prodh	10.62	"	"	"	"

81	131	"		31b	Sip.zhvesh	14.5	"	"	"	"
82	132	"	Kodra e Shitit	32a	Py.prodh	2.75	"	"	"	"
83	133	"	Kodra e Shitit	32c	Py.prodh	6.85	"	"	"	"
84	134	"	Kodra e Shitit	32c/1	Py.prodh	7.7	"	"	"	"
85	135	"		32d	Sip.zhvesh	12.25	"	"	"	"
86	136	"	Prroi i Mustafa Kocit	33a	Py.prodh	15.75	"	"	"	"
87	137	"		33b	Sip.joprod	3.5	"	"	"	"
88	138	"	Prroi i Mustafa Kocit	33c	Py.prodh	11.25	"	"	"	"
89	139	"	Prroi i Mustafa Kocit	33d	Py.prodh	8.5	"	"	"	"
90	140	"	Prroi i Mustafa Kocit	33d/1	Py.prodh	4	"	"	"	"
91	141	"		33e	Sip.zhvesh	11	"	"	"	"
92	142	"	Perroi i Mustafa Kocit	34a	Py.prodh	15.6	"	"	"	"
93	143	"	Perroi i Mustafa Kocit	34a/1	Py.prodh	0.7	"	"	"	"
94	144	"		34c	Livadh	4.25	"	"	"	"
95	145	"		34d	Sip.zhvesh	16.5	"	"	"	"
96	146	"		34e	Sip.joprod	1	"	"	"	"
97	147	"	Perroi i Mustafa Kocit	35a	Py.prodh	4.5	"	"	"	"
98	148	"		35c	Sip.zhvesh	34.5	"	"	"	"
99	149	"		35d	Livadh	5.5	"	"	"	"
100	150	"		35e	Sip.joprod	3.5	"	"	"	"
101	151	"		36a	Py.prodh	10.15	"	"	"	"
102	152	"		36a/1	Py.prodh	0.3	"	"	"	"
103	153	"		36c	Sip.zhvesh	14	"	"	"	"
104	154	"	Perroi i Shengjergjit	37a	Py.prodh	12.35	"	"	"	"
105	155	"	Perroi i Shengjergjit	37a/1	Py.prodh	2.2	"	"	"	"
106	156	"	Perroi i Shengjergjit	37c	Py.prodh	10.25	"	"	"	"
107	157	"	Perroi i Shengjergjit	37c/1	Py.prodh	1	"	"	"	"
108	158	"	Perroi i Shengjergjit	37d	Py.prodh	6.35	"	"	"	"
109	159	"	Perroi i Shengjergjit	37d/1	Py.prodh	1.2	"	"	"	"
110	160	"	Perroi i Shengjergjit	37e	Py.prodh	5.9	"	"	"	"
111	161	"	Perroi i Shengjergjit	37e/1	Py.prodh	0.8	"	"	"	"

112	162	"	Perroi i Shengjergjit	38a	Py.prodh	12.75	"	"	"	"
113	163	"	Perroi i Shengjergjit	38a/1	Py.prodh	1	"	"	"	"
114	164	"	Perroi i Shengjergjit	38b	Py.prodh	11.25	"	"	"	"
115	165	"		38c	Sip.zhvesh	5.5	"	"	"	"
116	166	"	Pylli i Ramushit	39a	Py.prodh	14.1	"	"	"	"
117	167	"	Pylli i Ramushit	39a/1	Py.prodh	1.8	"	"	"	"
118	168	"	Mali i Ramushit	39b	Py.prodh	20.5	"	"	"	"
119	169	"		39c	Sip.zhvesh	4.75	"	"	"	"
120	170	"	Mali i Ramushit	40a	Py.prodh	13.4	"	"	"	"
121	171	"	Mali i Ramushit	40a/1	Py.prodh	0.3	"	"	"	"
122	172	"	Mali i Ramushit	40b	Py.prodh	24.25	"	"	"	"
123	173	"		40c	Sip.zhvesh	3.25	"	"	"	"
124	174	"	Mali i Ramushit	41a	Py.prodh	25.85	"	"	"	"
125	175	"	Mali i Ramushit	41a/1	Py.prodh	0.2	"	"	"	"
126	176	"	Mali i Ramushit	41b	Py.prodh	6.4	"	"	"	"
127	177	"	Mali i Ramushit	41b/1	Py.prodh	0.3	"	"	"	"
128	178	"	Mali i Ramushit	41c	Py.prodh	18.1	"	"	"	"
129	179	"	Mali i Ramushit	41c/1	Py.prodh	3.2	"	"	"	"
130	180	"	Perroi i Shengjergjit	41d	Py.prodh	3	"	"	"	"
131	181	"		41e	Sip.zhvesh	7	"	"	"	"
132	182	"	Perroi i Bajzes	42a	Py.prodh	15.8	"	"	"	"
133	183	"	Perroi i Bajzes	42a/1	Py.prodh	4.1	"	"	"	"
134	184	"	Perroi i Bajzes	42c	Py.prodh	2.9	"	"	"	"
135	185	"	Perroi i Bajzes	42c/1	Py.prodh	1.3	"	"	"	"
136	186	"	Perroi i Bajzes	42d	Py.prodh	3.5	"	"	"	"
137	187	"	Perroi i Bajzes	42d/1	Py.prodh	2.5	"	"	"	"
138	188	"	Perroi i Bajzes	42e	Py.prodh	7.4	"	"	"	"
139	189	"	Perroi i Bajzes	42e/1	Py.prodh	0.8	"	"	"	"
140	190	"	Perroi i Bajzes	43a	Py.prodh	53.6	"	"	"	"
141	191	"	Perroi i Bajzes	43a/1	Py.prodh	2.2	"	"	"	"
142	192	"	Qafa e Rrushit	44a	Py.prodh	6.25	"	"	"	"

143	193	"	Qafa e Rrushit	44b	Livadh	3.5	"	"	"	"
144	194	"	Qafa e Rrushit	44c	Py.prodh	17.03	"	"	"	"
145	195	"	Qafa e Rrushit	44c/1	Py.prodh	4.36	"	"	"	"
146	196	"	Perroi i Rrushit	44d	Py.prodh	8.3	"	"	"	"
147	197	"	Perroi i Rrushit	44d/1	Py.prodh	1.6	"	"	"	"
148	198	"	Perroi i Shkozës	45a	Py.prodh	18.75	"	"	"	"
149	199	"		45b	Kullote	7.1	"	"	"	"
150	200	"		45c	Sip.zhvesh	30.75	"	"	"	"
151	201	"	Perroi i Bajzës	46a	Py.prodh	2.75	"	"	"	"
152	202	"	Perroi i Bajzës	46c	Py.prodh	7.3	"	"	"	"
153	203	"	Perroi i Bajzës	46c/1	Py.prodh	12.6	"	"	"	"
154	204	"	Bokat e Dushkut	47a	Py.prodh	1.9	"	"	"	"
155	205	"	Bokat e Dushkut	47a/1	Py.prodh	8.55	"	"	"	"
156	206	"	Bokat e Dushkut	48a	Py.prodh	4	"	"	"	"
157	207	"	Bokat e Dushkut	48a/1	Py.prodh	3	"	"	"	"
158	208	"	Kodra e Sules	49a	Py.prodh	15.9	"	"	"	"
159	209	"	Kodra e Sules	49a/1	Py.prodh	0.3	"	"	"	"
160	210	"		49c	Sip.zhvesh	13.75	"	"	"	"
161	211	"	Perroi i Goricës	50a	Py.prodh	21.1	"	"	"	"
162	212	"	Perroi i Goricës	50a/1	Py.prodh	0.2	"	"	"	"
163	213	"		50b	Sip.zhvesh	14.75	"	"	"	"
164	214	"	Perroi i Goricës	51c	Py.prodh	6.5	"	"	"	"
165	215	"	Perroi i Goricës	51c/1	Py.prodh	0.5	"	"	"	"
166	216	"		51d	Sip.zhvesh	21	"	"	"	"
167	217	"		51d/1	Py.prodh	2.4	"	"	"	"
168	218	"	Perroi i Bokavës	52a	Py.prodh	20.75	"	"	"	"
169	219	"	Perroi i Bokavës	52a/1	Py.prodh	4	"	"	"	"
170	220	"	Perroi i Bokavës	52c	Py.prodh	0.75	"	"	"	"
171	221	"	Perroi i Bokavës	52c/1	Py.prodh	1.5	"	"	"	"
172	222	"		52d	Sip.zhvesh	7	"	"	"	"
173	223	"	Perroi i Bokavës	53a	Kullote	3.8	"	"	"	"

174	224	"	Perroi i Bokave	53a/1	Kullote	2.85	"	"	"	"
175	225	"	Perroi i Bokave	53b	Sip.zhvesh	29	"	"	"	"
176	226	"	Perroi i Bokave	53b/1	Sip.zhvesh	0.9	"	"	"	"
177	227	"	Perroi i Bokave	54a	Py.prodh	7.55	"	"	"	"
178	228	"	Perroi i Bokave	54a/1	Py.prodh	1.1	"	"	"	"
179	229	"	Perroi i Bokave	54c	Py.prodh	2	"	"	"	"
180	230	"	Perroi i Bokave	54c/1	Py.prodh	4.25	"	"	"	"
181	231	"	Perroi i Bokave	54d	Sip.zhvesh	8.85	"	"	"	"
182	232	"	Perroi i Bokave	54d/1	Sip.zhvesh	0.7	"	"	"	"
183	233	"	Perroi i Hakcanit	55a	Py.prodh	2	"	"	"	"
184	234	"	Perroi i Hakcanit	55a/1	Py.prodh	0.9	"	"	"	"
185	235	"	Perroi i Hakcanit	56a	Py.prodh	27.35	"	"	"	"
186	236	"		56c	Kullote	2	"	"	"	"
187	237	"		56d	Sip.zhvesh	3.5	"	"	"	"
188	238	"	Perroi i Hakcanit	57a	Py.prodh	29	"	"	"	"
189	239	"	Perroi i Hakcanit	57a/1	Py.prodh	1.5	"	"	"	"
190	240	"	Perroi i Hakcanit	57c	Py.prodh	6.5	"	"	"	"
191	241	"	Perroi i Hakcanit	58a	Py.prodh	12	"	"	"	"
192	242	"	Perroi i Hakcanit	58a/1	Py.prodh	7.5	"	"	"	"
193	243	"		58c	Sip.zhvesh	12.75	"	"	"	"
194	244	"	Perroi i Hakcanit	59a	Py.prodh	13.75	"	"	"	"
195	245	"	Perroi i Hakcanit	59c	Py.prodh	16	"	"	"	"
196	246	"	Perroi i Hakcanit	59c/1	Py.prodh	0.9	"	"	"	"
197	247	"		59d	Sip.zhvesh	6	"	"	"	"
198	248	"	Pallosht	60a	Py.prodh	2	"	"	"	"
199	249	"	Pallosht	60a/1	Py.prodh	0.41	"	"	"	"
200	250	"	Pallosht	60c	Py.prodh	3.5	"	"	"	"
201	251	"	Perroi i Hakcanit	60d	Py.prodh	4.1	"	"	"	"
202	252	"	Perroi i Hakcanit	60d/1	Py.prodh	7.8	"	"	"	"
203	253	"	Perroi i Hakcanit	61a	Py.prodh	9.5	"	"	"	"
204	254	"	Perroi i Hakcanit	61a/1	Py.prodh	7.13	"	"	"	"

205	255	"	Perroi i Palloshit	62a	Py.prodh	11.01	"	"	"	"
206	256	"	Perroi i Palloshit	62a/1	Py.prodh	1.37	"	"	"	"
207	257	"	Perroi i Palloshit	62c	Py.prodh	3.41	"	"	"	"
208	258	"	Perroi i Palloshit	62c/1	Py.prodh	1.17	"	"	"	"
